



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"

SENATI AKADEMIK

Nr. 772 Prot.

Shkodër, më 21.02. 2025

V E N D I M

Nr. 54, datë 21.02 2025

"PËR MIRATIMIN E REDUKTIMIT TË NGARKESËS MËSIMORE TË STAFIT AKADEMIK TË ANGAZHUAR ME USHTRIMIN E FUNKSIONEVE NË STRUKTURAT ADMINISTRATIVE TË USH-SË"

Bazuar në ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 58, pika 1 dhe pika 8; Statutin e Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi", neni 46, pika 3; Udhëzimi i MASR nr. 29, datë 10.09.2018 "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë", i ndryshuar, pika 4, gërma e). nëndarja v); Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 21. 02. 2025;

VENDOSI:

1. Të miratojë reduktimin e ngarkesës mësimore të stafit akademik të angazhuar në strukturat administrative të USH-së, në norma fikse si më poshtë vijon:
 - Pozicioni "drejtor drejtorie", në 90 orë mësimore;
 - Pozicioni "përgjegjës sektori", në 100 orë mësimore;
 - Pozicioni "specialist", në 120 orë mësimore;
 - Personeli akademik i kategorizuar me orientim kërkimor- shkencor, i cili përfiton zbritje të ngarkesës mësimore me 35% sipas përcaktimit të Udhëzimit të MASR nr. 29, datë 10.09.2018 "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë", i ndryshuar, për shkak të emërimit në secilin prej pozicioneve administrative të cituar më lart, i reduktohet ngarkesa mësimore në një normë prej 15%.
2. Vendimi i SA, nr. 326, datë 11.10.2019 "Për miratimin e reduktimit të ngarkesës mësimore të stafit akademik të angazhuar në struktura administrative të USH-së", shfuqizohet.
3. Ky vendim i përcillet për miratim përfundimtar Bordit të Administrimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR SENATI

Prof. dr. Tomir GJURAJ

